



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës
Nr. 02-61/22-07
Prishtinë, më 27 shtator 2007
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi konstatoi se në seancë janë të pranishëm 72 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Seanca i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 14 e 17 shtatorit 2007;
2. Koha për pyetje parlamentare;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspeksionin bujqësor;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovës dhe praninë ushtarake ndërkombëtare, si dhe personelin e saj;
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrat e statusit civil;
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statusin civil;
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shoqëritë tregtare;
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin;
12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për parqet nacionale dhe
13. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit.

Në fillim të seancës, **kryesuesi** i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës së Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Në ndërkohë, nuk ka pasur asnjë propozim me shkrim për ta amendamentuar rendin e ditës.

Për fjalë u paraqit deputeti **Bajrush Xhemajli**, i cili kërkoi që, si çështje e ngutshme, Kuvendi të debatojë për vendimin e PSSP-së për ndarjen e një (1) milion € AKM-së pa pëlqimin e Kuvendit të Kosovës.

Deputeti **Xhevat Bislimi** kërkoi që Kuvendi të diskutojë dhe ta miratojë planin e veprimit pas 10 dhjetorit 2007.

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se Ministria e Punëve të Brendshme e kishte përgatitur një Informatë për gjendjen e sigurisë në Mitrovicë, por ajo nuk ishte radhitur për seancën e sotme, ngase ishte dorëzuar dje pasdite.

Seanca i vazhdoi punimet sipas rendit të propozuar të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 14 e 17 shtatorit 2007

Procesverbali i seancës plenare të 14 e 17 shtatorit 2007 u miratua pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Hydajet Hyseni** u parashtrroi pyetje Qeverisë së Kosovës dhe ministrit të Pushtetit Lokal lidhur me krijimin e kushteve siç janë: mungesa e repetitorëve për pranimin e sinjalit televiziv të Televizionit Publik; mungesa e lidhjeve telefonike; rrugët e dëmtuara për banorët e Restelicës me rrethinë; pamundësia e qarkullimit automobilistik tejkuftar me fshatrat fqinje në Shqipëri; pamundësia e shitjes së prodhimeve bujqësore e blegtorale; mungesa e kushteve për mësim edhe të gjuhës shqipe në shkollë.

Zëvendëskryeministri **Lutfi Haziri** dhe ministri **Sadik Idriz** iu përgjigjen pyetjes së deputetit Hyseni.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtrroi pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë lidhur me vazhdimin e veprimtarive në ndërmarrjet e privatizuara dhe kthimin e punëtorëve në vendet e punës.

Ministri **Bujar Dugolli** nuk ishte i pranishëm për t'iu përgjigjur deputetit Kelmendi.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtrroi pyetje ministres së Shërbimeve Publike lidhur me regjistrimin e popullsisë në Kosovë.

Ministrja **Melihate Tërmkollli** iu përgjigjur pyetjes së deputetit Bislimi.

Deputeti **Fetah Berisha** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me veprimet e Qeverisë për mbrojtjen e vendit “Verrat e Llukës”, ku është mbajtur Kuvendi i Pajtimit të Gjaqeve, sipas Ligjit për trashëgiminë kulturore.

Kryeministri **Agim Çeku** nuk ishte i pranishëm për t’iu përgjigjur pyetjes së deputetit Berisha.

Deputetja **Sala Berisha-Shala** i parashtrroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe Financave, Haki Shatri. Sa i kushton buxhetit të Kosovës shkollimi i shërbyesve civilë në fakultete private?

Ministri **Haki Shatri** nuk ishte i pranishëm në seancë, për t’iu përgjigjur pyetjes së deputetes Shala.

Deputetja **Sala Berisha-Shala** i parashtrroi pyetje zëvendësministrit të Bujqësisë lidhur me respektimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet kësaj Ministrie dhe Asociacionit të Komunave, përkatësisht Ministrisë dhe komunës së Drenasit.

Zëvendësministri **Tomë Hajdaraj** nuk ishte i pranishëm në seancë për t’iu përgjigjur pyetjes së deputetes Shala.

Deputetja **Saniye Alijaj** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me veprimet e Qeverisë për mbrojtje institucionale të familjeve të personaliteteve politike, që janë vrarë pas lufte.

Kryeministri **Agim Çeku** nuk ishte i pranishëm në seancë për t’iu përgjigjur pyetjes së deputetes Alijaj.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës

Kryesuesi e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja e Shërbimeve Publike, **Melihate Tërmkollli**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministrja **Tërmkollli** arsyetoi: qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, i radhitur në pesë kapituj dhe në 19 nene, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ana e ministres **Tërmkollli**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Nekibe Kelmendi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Hajredin Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Sylja**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Teuta Sahatqija**, në emër të Grupit Parlamentar 6+, **Mahir Yagcilar**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Ferid Agani**, si dhe deputetët: **Emrush Xhemajli**, **Numan Baliq**, **Gjylshene Berisha**, **Fetah Berisha**, **Xhevat Bislimi**, **Fatmir Rexhepi**, **Gani Koci**, **Agim Krasniqi**, **Naxhije Doçi** dhe **Kamber Kamberi**, të cilat iu janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund, ministrja **Tërmkoll** iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve dhe kërkoi nga ata që ta miratojnë këtë projektligj.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 68;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shërbime Publike – si komision përgjegjës dhe raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës

Kryesuesi e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri, **Lutfi Haziri**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, zëvendëskryeministri **Haziri** arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës, të radhitur në 12 nene, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ana e zëvendëskryeministrit **Haziri**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Euro-Atlantik, **Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Sylja**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Teuta Sahatqija**, në emër të Grupit Parlamentar 6+, Mahir Yagcilar, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxheri** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Ferid Agani**, si dhe deputetët: **Kamber Kamberi** dhe **Hydajet Hyseni**, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 68;

Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi njëzëri në parim Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Euro-Atlantik – si komision përgjegjës dhe raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovës dhe praninë ushtarake ndërkombëtare, si dhe personelin e saj

Kryesuesi e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri, **Lutfi Haziri**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, zëvendëskryeministri **Haziri** i arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovës dhe praninë ushtarake ndërkombëtare, si dhe personelin e saj, i radhitur në 12 nene, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ana e zëvendëskryeministrit **Haziri**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Sylja**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Teuta Sahatqija**, në emër të Grupit Parlamentar 6+, **Xhezair Murati**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Fadil Geci** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, **Ferid Agani**, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 62;

Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi njëzëri, në parim, Projektligjin për për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovës dhe praninë ushtarake ndërkombëtare, si dhe personelin e saj.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Euro-Atlantik – si komision përgjegjës dhe raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës

Kryesuesi e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri, **Lutfi Haziri**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, zëvendëskryeministri **Haziri** arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për provimin përfundimtar dhe të maturës, të radhitur në tre (3) kapituj dhe në 35 nene, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ana e zëvendëskryeministrit **Haziri**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Naxhije Doçi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Sala Ahmetaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Myrvete Dreshaj**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Genc Gorani**, në emër të Grupit Parlamentar 6+, **Shpresa Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi**, si dhe deputetët: **Zylfije Hundozi**, **Jonuz Kastrati**, **Sanije Aliaj** dhe **Sabri Hamiti**, të cilat i janë bashkangjitur trasnkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 67;
Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi njëzëri në parim Projektligjin për provimin përfundimtar dhe të maturës.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport – si komision përgjegjës dhe raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspeksionin bujqësor

Kryesuesi e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri, **Tomë Hajdaraj**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, zëvendësministri **Hajdaraj** arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për Inspeksionin bujqësor, i radhitur në shtatë (7) kapituj dhe në 32 nene, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ana e zëvendësministrit **Hajdaraj**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Shaban Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Xhelal Canziba**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Xhevdet Neziraj**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Gazmend Muhaxheri**, në emër të Grupit Parlamentar 6+, **Mahir Yagcilar**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxheri** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Ferid Agani**, të cilat i janë bashkangjitur trasnkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 60;
Kundër-----2..

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi njëzëri, në parim, Projektligjin për Inspeksionin bujqësor.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor – si komision përgjegjës dhe raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrat e statusit civil

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrat e statusit civil, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës dhe raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrat e statusit civil.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----63;
Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi njëzëri Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrat e statusit civil.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Statusin Civil

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për Statusin Civil, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës dhe raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me Projektligjin për statusit civil.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73 dhe 74.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----62;
Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi njëzëri Ligjin për statusin civil.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shoqëritë tregtare

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për shoqëritë tregtare, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës dhe raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Projektligjin për shoqëritë tregtare.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47(a), 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62 dhe 63.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----63;
Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi njëzëri Ligjin për shoqëritë tregtare.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës dhe raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Siguri lidhur me Projektligjin vendbanimin dhe vendqëndrimin.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40 dhe 41.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----63;
Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi njëzëri Ligjin për vendbanimin dhe vendqëndrimin.

12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për parqet nacionale

Kuvendi, pasi shqyrtoi rekomandimin e Komisionit lidhur me Projektligjin për parqet nacionale, mori këtë

V E N D I M

1. Projektligji për parqet nacionale i kthehet në ripunim propozuesit - Qeverisë së Kosovës.

A r s y e t i m i

Projektligji për parqet nacionale ka kundërshti me Ligjin për mbrojtjen e natyrës lidhur me menaxhimin e parqeve nacionale. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural dhe ajo e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor nuk kanë arritur ujdë lidhur me amendamentet divergjente, si dhe mosgatishmërinë e katër komunave për përfshirjen e sipërfaqes së tyre të paraparë për zonë të parkut nacional “Bjeshkët e Nemuna”.

13. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës të Kuvendit

Kryesuesi paraqiti kronologjinë e rrjedhës së procedurave lidhur me propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës të Kuvendit.

Ai propozoi që Kuvendi t’i miratojë amendamentet e propozuara nga Kryesia e Kuvendit dhe nga deputetët Hydajet Hyseni dhe Behxhet Brajshori për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës të Kuvendit.

Deputeti **Hydajet Hyseni** propozoi që amendamentet e propozuara për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullues së Punës të Kuvendit t’i kthehen Kryesisë.

Ai propozimin e arsyeoi se amendamentet u janë shpërndarë deputetëve vetëm një ditë para mbajtjes së seancës dhe duhet të përmirësohen disa gabime në to. Pastaj teksti i përmirësuar t’i procedohet seancës, për miratim.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se i mbështet amendamentet e propozuara për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës të Kuvendit.

Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së deklaroi se i mbështet amendamentet e propozuara për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës të Kuvendit.

Në mungesë të kuorumit, **kryesuesi** seancën e deklaroi të mbyllur në orën 18: 20 minuta.

Kjo pikë vazhdon në seancën e ardhshme.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë Berisha

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale